



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 599/1 prot.

Tiranë, më 15.05.2023

V E N D I M

Nr. 72, Datë 15.05.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 156 Regj, datë 06.10.2022, paraqitur nga ankuesi A.Z kundër Bashkisë Fier, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi A.Z deklaron se, është person me aftësi të kufizuara, me statusin i verbër i grupit të parë dhe ka nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi tjetër. Ai deklaron se banon i vetëm, pasi kujdestarja që kishte nuk kujdeset më për të. Në këto kushte, ankuesi shprehet se i është drejtuar Shtëpisë së të Moshuarve Fier, që t’u pranonin të jetonte në këtë institucion, duke dorëzuar dokumentacionin që i është kërkuar, por u refuzua me pretendimin se është i verbër dhe nuk mund të kujdeset njëri për të në këtë institucion. Z.Z. shprehet se, në mënyrë sistematike ka bërë përpjekje pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, në Bashkinë Fier, por është ndjerë i refuzuar dhe i diskriminuar nga ana e drejtorit të shërbimit social, z. A.M.

Ankuesi deklaron se përmbush të gjitha kriteret ligjore për të përfituar nga ky shërbim që ofrohet nga ana Bashkisë Fier dhe se është plotësisht i aftë për të kryer shërbimet që lidhen me autonominë personale. Më tej, ankuesi shton se, ai është i moshur, 66 vjeç dhe është plotësisht i

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

vetmuar dhe pa asnjë njëri që mund të ofrojë shërbime ndihmëse dhe për këtë arsye situata e tij duhet të vlerësohet me prioritet.

Nëpërmjet ndihmës juridike falas, ankuesi i është drejtuar me shkresë Drejtorisë së Shërbimit Social, pranë Bashkisë Fier, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Në vijim, i është drejtuar sërish me shkresë bashkisë dhe përgjigja që ka marrë ka qenë një përgenjshtrim i të gjitha komunikimeve verbale që ankuesi ka patur me përfaqësuesit e këtij institucioni. Qasja diskriminuese duket haptazi, pasi Drejtoria e Shërbimit Social e Bashkisë Fier, ka përgenjshtruar faktin që i ka propozuar verbalisht (jo zyrtarisht) ankuesit, për ta sistemuar në azilin e Poliçanit apo Gjirokastrës.

Ankuesi deklaroi se e ka refuzuar vlerën e ofruar prej 40.000 lekë, me qëllim pagesën brenda kësaj vlere të një kujdestareje. Në bazë të statusit të të verbërit, një kujdestare paguhet 12.000 lekë dhe nuk gjendet asnjë person me këtë vlerë. Kjo nuk do të jetë e përhershme dhe ai do të jetë gjithmonë në kërkim të një kujdestari, ndërsa sistemimi i tij në azile do të ofronte një pleqëri dinjitoze.

Ankuesi pretendon se nuk ka asnjë pengesë ligjore që ai të përfitojë nga e drejta që i takon. Ai pretendon se nuk pranohet në azil pasi është i verbër dhe se një fakt i tillë përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe vjen në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”, ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë”.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e situatës së tij, duke marrë masa për pranimin e tij në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe ligjit “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminim garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1347/1 prot, datë 13.10.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Fier, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Në vijim të kësaj kërkesë, me shkresën nr.8743/1 prot., datë 21.10.2022³, Bashkia Fier ka kthyer përgjigje në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë, duke parashtruar:

Drejtoria e Shërbimit Social në bashki i referohet VKM-së nr.518 datë 04.09.2018, për ofrimin e shërbimit në Shtëpinë e të Moshuarve Fier. Bazuar në këtë VKM, kritereve të përcaktuara dhe detyrave, ka ngritur dhe funksionon Komisioni i Vlerësimit të Nevojave të Referimit të Rastit. Pas vlerësimit të çdo rasti të paraqitur, Komisioni harton relacionin, i cili është bazë për vendimin që merr Këshilli i Bashkisë për akomodim në këtë shtëpi. Theksojmë këtu se, Këshilli i Bashkisë merr vendim vetëm për personat që banojnë në territorin respektiv të bashkisë qendër qarku, që administrojnë Shtëpinë e të Moshuarve.

Rasti në fjalë nuk është shqyrtuar, pasi z. Z. akoma nuk ka depozituar në bashki dokumentacionin e kërkuar sipas VKM-së, së sipërcituar. Personit, siç përmend edhe ai vetë në ankesë, i është sugjeruar një pagesë shtesë për kujdestarin (të cilin duhet ta gjejë vetë e të jetë i besuari i tij), pagesë që së bashku me pagesën e kujdestarisë që merr, do të shkonte në rreth 40.000 lekë në muaj, vetëm për kujdestarin. Ky sugjerim dashamirës, është bërë në kushtet në të cilat ndodhet z.Z., por edhe mundësisë reale të kujdesit në Shtëpinë e të Moshuarve për këtë kategori (një person me A.K-verbëri-i grupit të parë dhe në kushtet e mungesës së plotë të shikimit) Refuzimi ka ardhur nga ana e z. Z..

Në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, nuk është pranuar asnjë person me aftësi të kufizuar. Por nëqoftëse i moshuari gjatë qëndrimit në këtë institucion, humbet aftësinë e vetëshërbimit, atëherë është detyra e institucionit t'i shërbejë, edhe pse i kufizohen aftësitë jetësore. Ky është edhe qëllimi përse kërkohet raport mjekësor përpara shqyrtimit të dokumentacionit për praninë nga ana e komisionit. Shtëpia e të Moshuarve është shtëpi sociale, por jo institucion spitalor.

Pretendimet e ngritura nga ana e tij për refuzim apo diskriminim nuk janë reale. Është absurde të mendosh që Bashkia Fier administrojë edhe Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër apo Poliçan. Përgjigjen ia kemi kthyer zotërisë, në të vetmen ankesë të dokumentuar zyrtarisht, që ka bërë në bashki.

2. Me shkresën nr. 1347/3 prot., datë 03.11.2022, Komisioneri i është drejtuar me një kërkesë për informacion SHSSH, në lidhje me çështjet e mëposhtme:

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1347/2 prot., datë 24.10.2022.

- A përfiton aktualisht z. A.Z “Statusin e të Verbërit”? Nëse po, çfarë grupi është dhe si janë vlerësuar nevojat e tij për ndihmës personal?
- A ka pengesë ligjore që një i moshuar me aftësi të kufizuar, të përfitojë nga shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve?

Më shkresën nr.2268/1 prot., datë 10.11.2022⁴, Shërbimi Social Shtetëror, ka kthyer përgjigje, duke informuar Komisionerin, si më poshtë:

Z. A.Z përfiton statusin e të verbërit grupi i parë, me vendimin nr.7348 dhe është e vlefshme që prej datës 08.01.2020, të cilën e gëzon përgjithmonë.

Lidhur me kuadrin ligjor për përfitimin ose jo të shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuar që kanë aftësi të kufizuar, bazuar në VKM nr. 518 datë 04.09.2018 “*Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës së shpenzimeve personale për përfituesit e shërbimit të organizuar*”, kriteret për të moshuarit që kërkojnë akomodim në IPSH publike janë:

- a) përfituesit e shërbimit kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;
- b) përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës;
- c) nuk zotërojnë banesë ose llogari bankare;
- d) janë të vetmuar dhe të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga punonjësit social në njësinë vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit;

Si rrjedhojë, kuadri ligjor nuk i përjashton të moshuarit me aftësi të kufizuar për sistemim në institucione përkujdesi. Shërbimi Social Shtetëror nuk i ka refuzuar kërkesat e personave të moshuar me probleme të aftësisë së kufizuar, që plotësojnë të gjithë kriteret e sipërpërmendura për sistemim në Shtëpi të Moshuarish. Aktualisht në këto qendra ka të moshuar me aftësi të kufizuar dhe marrin të gjitha shërbimet e duhura në përputhje me nevojat e tyre.

3. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 1347/5 prot datë 29.12.2022, njoftoi palët për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike në datën 11.01.2023.

Seanca dëgjimore nuk u zhvillua, pasi asnjë nga palët e përfshira në procedurën administrative, ankuesi A.Z dhe Bashkia Fier, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, nuk u paraqitën në seancë dëgjimore.

Nëpërmjet e-mailit të datës 09.01.2023, z. A.M, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Qendrës së Fëmijëve me Aftësi Ndryshe, pranë Bashkisë Fier, informoi Komisionerin

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1347/4 prot., datë 14.11.2022.

se: *“Në pamundësi për të ardhur në Tiranë pranë mjediseve të zyrës suaj për shkak të angazhimeve të shumta që kemi dhe stafit të reduktuar, nuk mund të marrim pjesë në seancë dëgjimore. Do t’ju luteshim që takimi të organizohet pranë zyrës së Komisionerit në Fier, duke qenë se edhe personi që është ankuar jeton në Fier”.*

Në seancë dëgjimore u njoftua për të marrë pjesë Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier, e cila në bazë të akteve të administruara kishte dijeni për problematikën, pasi ka asistuar me ndihmë juridike parësore ankuesin. Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier (QSHNJP Fier), informoi Komisionerin se nuk mund të paraqitej në seancë dëgjimore, pasi ankuesi nuk kishte shprehur vullnetin për të lëshuar aktin që do të mundësonte përfaqësimin e interesave të tij nga ana e QSHNJP Fier.

Nga ana tjetër, vetë ankuesi nuk informoi Komisionerin në lidhje me arsyet e mosparaqitjes së tij në seancë dëgjimore dhe nuk paraqiti ndonjë kërkesë tjetër në lidhje me zhvillimin e seancës dëgjimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Në përfundim të procedurës administrative të zhvilluar për shqyrtimin e ankesës dhe provave të administruara, rezultuan të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Ankuesi A. Z., është i datëlindjes 10.04.1956 dhe banon në qytetin e Fierit. Bazuar në të dhënat e pasqyruara në certifikatën familjare të datës 13.05.2022, rezulton se ankuesi A.Z figuron me gjendje civile “i divorcuar” dhe është kryefamiljar i vetëm. Sipas vërtetimit datë 08.01.2015, lëshuar nga Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë, pranë SHSSH, rezulton se ankuesi ka përfitur “Statusin e të Verbërit”, grupi i parë, për periudhën 08.01.2015 deri në datë 08.01.2020. Në bazë të vendimit nr. 7848, që prej datës 08.01.2020, ankuesi A. Z., përfiton nga statusi i të verbërit, grupi i parë, duke e gëzuar këtë status përgjithmonë, fakte këto që rezultojnë të provuara nga shkresa nr. 2268/1 prot, datë 10.11.2022, e SHSSH. Ankuesi është një person mbi moshë pune, pasi është mbi moshën e përcaktuar të punës sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Ankuesi pretendon se me gjithë përpjekjet sistematike që ka bërë pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, në Bashkinë Fier, është refuzuar dhe diskriminuar. Në këto kushte, ai i është drejtuar Bashkisë Fier me një kërkesë në lidhje me shqetësimin e tij dhe që të bëhej e mundur sistemimi i tij në Shtëpinë e të Moshuarve pranë kësaj bashkie. Rezulton se me shkresën nr. 7601/1 prot, datë 20.09.2022, Bashkia Fier i ka kthyer përgjigje ankuesit, ku ndër të tjera e informon se: *“.....Duke qenë se Shtëpia e të Moshuarve është një institucion social, me një numër të kufizuar punonjësish, është e pamundur të asistojë një person të tillë gjithë kohën. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë, bazuar në kuadrin ligjor, ju është ofruar edhe një mundësi për një person, i cili do të*

kujdesej për ju, duke miratuar në Këshillin Bashkiak dhe një pagesë për këtë qëllim, gjë që ju e keni refuzuar. Pas kësaj në takimin që keni patur me Drejtorinë e Shërbimit Social, ju është rekomanduar plotësimi i dokumentacionit përkatës dhe depozitimi i tij zyrtarisht. Kjo procedurë do t'ju hapte rrugë edhe vlerësimin nga ana e Komisionit të Vlerësimit të nevojave dhe Referimit të Rastit, e më pas, kalimit në Këshillin e Bashkisë për vendimmarrje. Por deri tani nuk ka asnjë dosje me dokumentacion në emrin tuaj.....Në përfundim, ju sugjerojmë të plotësoni dokumentacionin përkatës dhe ta depozitoni në bashki për veprime të mëtejshme, siç përcaktohet edhe në VKM nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror.....”

Ankuesi parashtron se në kushtet në të cilat ai ndodhej, si një njeri në moshën 66 vjeçare, i cili jeton i vetmuar dhe pa asnjë njeri që mund ti ofrojë shërbime ndihmëse dhe nevojës për përkujdesje të vazhdueshme, i është drejtuar Shtëpisë së të Moshuarve pranë Bashkisë Fier duke dorëzuar dhe dokumentacionin e kërkuar. Me pretendimin se ankesa e tij për t'u pranuar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier është refuzuar pasi ai është i verbër dhe nuk mund të kujdeset njeri për të, ankuesi ka depozituar pranë Komisionerit ankesën nr. 156 datë 06.10.2022, duke pretenduar se është diskriminuar nga Bashkia Fier për shkak të aftësisë së kufizuar.

Shtëpia e të Moshuarve Fier, është një institucion i përkujdesit shoqëror (IPSH) ku ofrohen shërbime rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit dhe është në administrimin e Bashkisë Fier. Ofrimi i shërbimit pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier, rregullohet bazuar në ligjin Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji Nr.121/2016) , i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror (neni 1, i ligjit), si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.518, datë 04.09.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” (në vijim VKM nr.518, datë 04.09.2018)

Sipas nenit 5, të ligjit nr. 121/2016, të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t'ju sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale. Në nenin 6, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 121/2016, përcaktohet se të moshuarit në nevojë janë një grup shoqëror që përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shoqëror.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror (neni 3, pika 1, ligji nr.121/2016). Referuar nenit 8, të ligjit nr.121/2016, një nga llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, janë shërbimet në

qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat. *Shërbime rezidenciale*, janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike (neni 3, pika 2 e ligjit nr.112/2016). Bazuar në nenin 17, të ligjit nr.121/2016, *shërbimi në strehëza*, është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial i ofruar në mënyrë të përkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit. Sipas germës “c”, të pikës 2, të dispozitës së mësipërme, një ndër kategoritë përfituese të shërbimit në streha janë të moshuarit, të cilët nuk kanë vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk janë në gjendje të kujdesen për vete.

Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, rregullohet nga neni 28, i ligjit nr.121/2016, ku përcaktohet si vijon: “1. Pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror fillon me kërkesë të individit në nevojë, përfaqësuesit të tij, psikologut, por mund të fillojë edhe kryesisht nga punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore kur konstatohet situata e nevojës për shërbime. 2. Kërkesa për të përfituar shërbime të kujdesit shoqëror paraqitet te punonjësi social i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit në strukturën e posaçme për shërbimet shoqërore të njësisë së qeverisjes vendore. 3. Këshilli bashkiak vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës për pranimin në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Vendimet e keshillit bashkiak mund të ankimohen në rrugë gjyqësore.....”

Bazuar në pikën 5, të nenit 8, të ligjit nr. 121/2016, parashikohet se kriteret dhe procedurat e pranimit në qendrat rezidenciale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret dhe procedurat për përfitimin e shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuar, parashikohen në VKM nr. 518, datë 04.09.2018. Në këtë akt bëhen rregullimet e mëposhtme:

“II. SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR KOMUNITAR E REZIDENCIAL

11. Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe, në çdo rast, përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë.

Në këtë shërbim përfshihen:

.....

c) Shërbimi në strehëza, që u siguron përfituesve shërbim specifik, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim rezidencial ofrohet në mënyrë të përkohshme:

.....

iii. për të rriturin ose të moshuarin që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;

III. PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNITARE E REZIDENCIALE

13. *Procesi i përfitimit të shërbimeve komunitare dhe rezidenciale fillon me kërkesën e paraqitur nga:*

- a) *Individi apo familja në nevojë për shërbimin specifik;*
- b) *Punonjësi i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit;*
- c) *Organizata joqeveritare dhe ofrues të shërbimeve publike e jopublike;*
- ç) *Punonjësi i policisë së shtetit;*
- d) *Punonjësi apo institucionet që janë në kontakt me individin apo familjen në nevojë për shërbim;*
- dh) *Çdo person tjetër i interesuar.*

14. *Kërkesa për marrjen e shërbimit në qendra komunitare apo shërbim rezidencial, me përjashtim të shërbimeve të emergjencës, kryhet pranë punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, i cili drejton procesin e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përdorimin e shërbimit specifik dhe i siguron dokumentet e nevojshme nëpërmjet kërkesës në institucionet përkatëse ose Regjistrin Elektronik Kombëtar.*

.....
17. *Punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, brenda 10 ditësh nga fillimi i procesit të përfitimit të shërbimit, sipas përcaktimit të pikës 13 të këtij kreu, pasi merr informacionin e plotë nga sistemet e jashtme, e kalon informacionin te komisioni multidisiplinar, i ngritur në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të bërë vlerësimin e plotë të rastit.*

18. *Komisioni multidisiplinar shqyrton kërkesën e dokumentacionin dhe, pas marrjes së vendimit, përcjell vendimin e dokumentacionin pranë ofruesit të shërbimit ose, në rast refuzimi, pranë njësisë që ka marrë nismën për vendosjen e individit në institucion përkuqdesi rezidencial.*

.....
23. *Me përjashtim të viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe të mundshme të trafikimit, për individët dhe familjet në nevojë, vendimi për t'i ofruar shërbimin e kërkuar merret brenda një muaji nga data e kërkesës nga:*

- a) *Këshilli i Bashkisë, në rastin kur shërbimi i kërkuar funksionon në territorin e bashkisë respektive ku banon individi apo familja në nevojë mbi bazën e propozimit të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkisë;*

IV. KRITERET E PËRFITIMIT TË SHËRBIMIT DHE PËRMBAJTJA E DOSJES

58. *Shërbimi në strehëza për të moshuarit, sipas përcaktimit të pikës 11/c/iii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere:*

- a) *Përfituesit e shërbimit kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;*
- b) *Përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës;*
- c) *Nuk zotërojnë banesë apo llogari bankare;*
- ç) *Janë të vetmuar dhe të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.*

59. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:...”

Sa më sipër, rezulton se kuadri ligjor dhe nënligjor nuk i përjashton të moshuarit me aftësi të kufizuar për tu sistemuar në institucione përkujdesi ku ofrohen shërbime rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit, sikurse është Shtëpia e të Moshuarve Fier.

Bashkia Fier pretendoi se, rasti i ankuesit nuk është shqyrtuar, pasi ai nuk ka depozituar në bashki dokumentacionin e kërkuar sipas VKM nr. 518, datë 04.09.2018. Nga ana tjetër ankuesi pretendon se, ai me gjithë përpjekjet sistematike që ka bërë pranë Drejtorisë së Shërbimit Social të Bashkisë Fier, është ndjerë i refuzuar dhe i diskriminuar.

Sikurse rezulton nga neni 28, i ligjit nr.121/2016 dhe VKM nr.518, datë 04.09.2018, pranimi në sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe procesi i përfitimit të shërbimeve rezidenciale në Shtëpinë e të Moshuarve mund të fillojë edhe me nismën e subjekteve të tjerë të cilë marrin dijeni për nevojën e individit për shërbime të kujdesit shoqëror. Një ndër subjektet e parashikuara që mund të fillojë procesin dhe të paraqesi kërkesën për të përfituar nga shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve është edhe punonjësi i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

Një qasje e tillë duke legjitimuar subjekte të tjerë përveç individit për të paraqitur kërkesën, nuk është bërë pa qëllim, duke mbajtur në konsideratë që shërbimet e kujdesit shoqëror, synojnë të ndihmojnë në mirëqënien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e familjeve në nevojë. Ligji nr.121/2016 dhe VKM nr.518/04.09.2018, në mënyrë të veçantë i kanë dhënë bashkisë një rol shumë në rëndësishëm në sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në nenin 36 “Roli i bashkisë”, të ligjit nr.121/2016, parashikohet: “1. Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj: a) duke identifikuar nevojat; b) duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; c) duke hartuar planin social vendor;

ç) duke programuar buxhetet vendore; d) duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;

dh) duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror. 2. Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror. 3. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.....”

Në nenin 37 “Roli i punonjësit social të njësisë së qeverisjes vendore”, parashikohet: “Punonjësit socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për

shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë: a) të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve; b) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;

Kuadri ligjor dhe nënligjor që rregullon sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, tregon se bashkia është autoriteti i cili është përgjegjës për ofrimin dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror brenda territorit të saj, nëpërmjet strukturave të saj të posaçme për administrimin e këtyre shërbimeve. Sipas ligjit, roli i bashkive në fushën e sigurimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nuk është pasiv, pra në pritje vetëm të kërkesave të individëve në nevojë për të përfituar shërbimet e kujdesit shoqëror, por është një rol aktiv në drejtim të identifikimit të rasteve dhe individëve në nevojë. Bashkia, nëpërmjet strukturave të saj të posaçme për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ka një rol shumë të rëndësishëm edhe në drejtim të përgatitjes së dokumentacionit. Në mënyrë specifike, pika 14, e VKM nr.518, datë 04.09.2018, thekson se, kërkesa për marrjen e shërbimit në qendra komunitare apo shërbim rezidencial, me përjashtim të shërbimeve të emergjencës, kryhet pranë punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit. Pra, pavarësisht se kërkesa me shkrim paraqitet nga personi i interesuar, kjo kërkesë detyrimisht duhet të kryhet vetëm pranë punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

Po sipas pikës 14, të VKM nr. 518, datë 04.09.2018, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, është ai që drejton procesin e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përdorimin e shërbimit specifik dhe i siguron dokumentet e nevojshme nëpërmjet kërkesës në institucionet përkatëse ose Regjistrin Elektronik Kombëtar. Në vijim, në pikën 59, të VKM nr.518, datë 04.09.2018, ku specifikohet dokumentacioni që duhet të jetë pjesë e dosjes, theksohet se, është punonjësi social i qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, ai që plotëson dosjen e individit me dokumentacionin e kërkuar. Pra, detyrimi për të mbledhur dokumentacionin nuk qëndron mbi subjektin e interesuar për të përfituar shërbimet e kujdesit shoqëror por mbi strukturat përkatëse të bashkisë që janë përgjegjëse për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Duke ju rikthyer rastit në shqyrtim, rezulton se Bashkia Fier dhe strukturat e saj të posaçme të ngarkuara me administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, kanë qenë në dijeni të kërkesës së ankuesit për të sistemuar pranë Shëpisë së të Moshuarve Fier. Bashkia Fier sikurse konfirmohet edhe nga ankuesi, i ka propozuar këtij të fundit një pagesë prej 40.000 lekë në muaj me qëllim që ai të siguronte një kujdestar. Sipas Bashkisë Fier, një propozim i tillë i është bërë ankuesit në mënyrë “dashamirëse” për kushtet në të cilat ndodhet z. Z. por edhe mundësisë reale të kujdesit në Shtëpinë e të Moshuarve për këtë kategori, një person me A.K – verbëri – i grupit të parë dhe në kushtet e mungesës së plotë të shikimit. Në lidhje me këtë propozim të bërë nga

Bashkia Fier në lidhje me nevojat e ankuesit, sikurse rezulton edhe nga fakti që vetë bashkia i referohet zgjidhjes së propozuar si një zgjidhje “dashamirëse”, konstatohet se propozimi nuk shoqërohet me informacionin e mjaftueshëm mbi bazën ligjore se ku bazohet një propozim i tillë apo kohëzgjatjen e kësaj zgjidhje të propozuar.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Fier, ka detyrimin që të identifikojë nevojat e personave që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Fier si dhe detyrimin, jo vetëm për të drejtuar procesin e aplikimit por edhe për të siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të VKM nr.518, datë 04.09.2018. Komisioneri konstaton se, Bashkia Fier ka patur dijeni për nevojën e ankuesit për të përfituar nga shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, e megjithatë nuk ka marrë asnjë masë që ankuesi A.Z t'i nënshtrohet procesit dhe për të vlerësuar nëse ankuesi mund të sistemohet apo jo pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier. Rrjedhimisht, pretendimi i Bashkisë Fier se, rasti i ankuesit nuk është shqyrtuar pasi ai nuk ka depozituar në bashki dokumentacionin e kërkuar sipas VKM nr.518, datë 04.09.2018, është i pabazuar, pasi me identifikimin e nevojave dhe kërkesës së ankuesit për t'u sistemuar pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier, bashkia duhet të kishte marrë masat dhe duhet të kishte vepruar në përputhje me rolin dhe detyrimet e saj, që ankuesi t'i nënshtrohej procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes nga autoritetet përgjegjëse.

Pavarësisht se ankuesi nuk i është nënshtrohet formalisht procesit të vlerësimit dhe nuk ka një vendimmarrje formale në lidhje me kërkimin e tij për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, duke mbajtur në konsideratë sjelljen pasive dhe mosveprimin nga ana e Bashkisë Fier, për të përmbushur detyrimet që ajo ka në drejtim të administrimit të procesit të përfitimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe përgjigjen që Bashkia Fier i ka kthyer ankuesit me shkresën nr.7601/1 prot datë 20.09.2022, se “...*Duke qenë se Shtëpia e të Moshuarve është institucion social, me një numër të kufizuar punonjësish, është e pamundur të asistojë një person të tillë gjithë kohën....*”, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Fier e ka deklaruar vullnetin e saj refuzues ndaj kërkesës së ankuesit për tu akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, duke i komunikuar atij se, është e pamundur të asistojë një person në kushtet e ankuesit, person me aftësi të kufizuara në shikim.

Përfundimisht, duke u bazuar në gjithë sa më sipër është konstatuar dhe arsyetuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, me sjelljen dhe mosveprimin e saj Bashkia Fier, e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, në kuadër të procesit të përfitimit të shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit të ofruara në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, **aftësinë e kufizuar**, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në ankesën e depozituar ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar. Referuar akteve të administruara rezulton se ankuesi A.Z është person me aftësi të kufizuara në shikim dhe përfiton “Statusin e të Verbrit”, grupi i parë, status të cilin e gëzon përgjithmonë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar faktin se ankuesi mbart shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Shqyrtimi i pretendimeve, nëse trajtimi të padrejtë, të disfavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi, përbën diskriminim, do të bazohet në kuadrin e mëposhtëm ligjor.

Neni 18, i Kushtetutës, i cili sanksionon parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, sanksionon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. (Vendimi nr. 18, datë 29.07.2008, Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, Vendimi nr. 4, datë 12.02.2010, Vendim nr. 31 datë 04.10.2021)

Neni 59 “Objektivat social”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët; ...”.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të

rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), nuk parashikon një të drejtë të veçantë në lidhje me shërbimet shoqërore dhe nuk adreson në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtat e personave të moshuar. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka interpretuar se aftësia e kufizuar⁵ dhe moshë⁶, gëzojnë mbrojtje nga diskriminimi në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”. Ndërkohë Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

*Karta Sociale Europiane*⁷, e rishikuar në nenin 14 “E drejta për të përfituar nga shërbimet e mirëqënies sociale”, pika 1, parashikon: “Me synimin për të siguruar një ushtrim efektiv të së drejtës për shërbime të mirëqënies sociale, Palët angazhohen: 1 të nxisin ose të ofrojnë shërbime të cilat, duke përdorur metoda të punës sociale, do të kontribuonin në mirëqënien dhe zhvillimin e individëve dhe grupeve në komunitet dhe përshtatjen e tyre në mjedisin social;”. Karta Sociale, e rishikuar adreson të drejtën e personave të moshuar për mbrojtje sociale, në nenin 23, të saj, ku parashikohet:

“ Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtave të personave të moshuar për mbrojtje sociale, Palët angazhohen të marrin dhe inkurajojnë, direkt ose në bashkëpunim me organizata publike ose private, masa të përshtatëshme që synojnë veçanërisht:

- të mundësojnë personat e moshuar që të mbeten anëtarë të plotë të shoqërisë për sa më gjatë të jetë e mundur, nëpërmjet:
 - a. burimeve të përshtatëshme që mundësojnë ata të bëjnë një jetë të përshtatëshme dhe të luajnë një rol aktiv në jetën publike, sociale dhe kulturore;
 - b. ofrimit të informacionit për shërbimet dhe lehtësitë në dispozicion për personat 44 e moshuar dhe mundësitë e tyre për t'i përdorur ato;
- të mundësojnë personat e moshuar të zgjedhin lirisht mënyrën e tyre të jetesës dhe të bëjnë një jetë të pavarur në mjedisin e tyre familjar për sa kohë që ata e dëshirojnë dhe kanë mundësi ta bëjnë, nëpërmjet:
 - a. ofrimit të strehimit të përshtatshëm për nevojat e tyre dhe gjendjen e tyre të shëndetit ose mbështetjes së përshtatëshme për përshtatjen e vendbanimit të tyre;
 - b. kujdesit shëndetësor dhe shërbimet e nevojshme për gjendjen e tyre;
- garantimit të personave të moshuar që jetojnë në institucione mbështetje të përshtatëshme, duke respektuar privatësinë e tyre dhe pjesëmarrjen në vendime lidhur me kushtet e jetesës në institucion.”

⁵ Shiko: *Glor kundër Zvicrës*, Aplikimi Nr. 13444/04, 30.04.2009; *Guberina kundër Kroacisë*, Aplikimi Nr. 23682/13, 22.03. 2016.

⁶ Shiko: *Schwizgebel kundër Switzerland*, Aplikimi Nr. 25762/07, 10.06. 2010.

⁷ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Evropiane, ku parashikohet: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër.” Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS), ka interpretuar se, aftësia e kufizuar përbën një shkak të mbrojtur nga diskriminimi, në kuadër të çdo “statusi tjetër”.⁸

Me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁹, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (në vijim KDPAK). KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni 1). Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalitetit dhe ambientit që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paafhtësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave.

KDPAK, garanton të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet të personave me aftësi të kufizuar në nenin 19, ku sanksionohet :

“Shtetet palë në këtë konventë pranojnë të drejtën e barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara për të jetuar në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët, dhe duhet të marrin masat e duhura dhe efektive për të mundësuar që personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht këtë të drejtë dhe përfshirjen e pjesëmarrjen e tyre të plotë në komunitet, përfshirë dhe sigurimin e faktit se:

- a) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësinë për të zgjedhur vendin e tyre të banimit, ku dhe me kë do të jetojnë në baza të barabarta me të tjerët dhe nuk janë të detyruar të jetojnë në një mënyrë të veçantë të caktuar jetese;*
- b) Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi për një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, shërbime rezidenciale dhe shërbime në komunitetet, dhe për parandalimin e izolimit dhe veçimit nga komuniteti;*

⁸ Shiko: *European Action of the Disabled (AEH) kundër Francës*, Ankesa Nr. 81/2012, 11 .09. 2013, prg. 132; *International Association Autism-Europe kundër Francës*, Ankesa Nr. 13/2002, 4 .11. 2003, prg. 51.

⁹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën KDPAK.

c) Shërbimet dhe mjetet komunitare për popullatën në përgjithësi janë të disponueshme në baza të barabarta për personat me aftësi të kufizuara dhe u përgjigjen nevojave të tyre.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.(në vijim ligji nr. 93/2014) Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.” Një nga parimet bazë të këtij ligji, sanksionuar nga neni 4, germa ‘a’, të këtij ligji është parimi i mosdiskriminimit, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë.

Në nenin 5 “ Jetesa e pavarur”, e ligjit nr.93/2014, sanksionohet : “ 1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare. 2. Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht: d) në shërbime shoqërore; ...”

Një nga parimet mbi bazën e të cilit administrohen shërbimet shoqërore, sipas ligjit nr.121/2016 është parimi i mosdiskriminimit, sipas të cilit ndalohet çdo formë diskriminimi ndaj përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

LMD, i cili është legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi garanton mbrojtje nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar ndërsa në nenin 20, të tij, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Konkretisht në nenin 20, pika 1 dhe pika 2, germa “c”, të LMD, parashikohet: “ 1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;..... ”.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përliqjes së arsyeshme dhe objektive. (vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁰. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹¹. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”¹²

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përliqur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

¹⁰ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

¹¹ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

¹² Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016*, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: “*“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”. LMD jep shprehimisht përkufizimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, në nenin 3, pika 2, sipas përmbajtjes vijuese: “2. *“Diskriminim i drejtëpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.*”

Bazuar në nenin 5, të LMD, ndalohej diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “7/1. *Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*” Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon : “2. *Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.*”

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur/shpërndarë barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹³

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë trajtim të mundshëm diskriminues dhe ekzistencës së këtij trajtimi në realitet. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim. Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Ankuesi A.Z është një person i moshuar, me aftësi të kufizuar. Në kushtet e nevojës ai ka kërkuar nga Bashkia Fier që të akomodohet pranë Shëtpisë së të Moshuarve Fier dhe të përfitojë nga shërbimet e kujdesit rezidencial të kujdesit shoqëror që ofrohen për të moshuarit pranë këtij institucioni të përkujdesit shoqëror, nën administrimin e Bashkisë Fier. Sa më sipër rezultoi e provuar se, me sjelljen dhe mosveprimin e saj Bashkia Fier, e ka ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, në kuadër të procesit të përfitimit të shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit të ofruara në Shtëpinë e të Moshuarve Fier.

Nëpërmjet shkresës nr.8743/1 prot datë 21.10.2022, Bashkia Fier parashtrroi se në Shtëpinë e të Moshuarve Fier nuk është pranuar asnjë person me aftësi të kufizuar. Por nëqoftëse i moshuari gjatë qëndrimit në këtë institucion, humbet aftësinë e vetëshërbimit, atëherë është detyra e institucionit t'i shërbejë, edhe pse i kufizohen aftësitë jetësore. Ky është edhe qëllimi përse kërkohet raport mjekësor përpara shqyrtimit të dokumentacionit për pranim nga ana e komisionit. Shtëpia e të Moshuarve është shtëpi sociale, por jo institucion spitalor. Ndërsa me shkresën nr.7601/1 prot, datë 20.09.2022, Bashkia Fier ka informuar ankuesin se, Shtëpia e të Moshuarve duke qenë një institucion social, me një numër të kufizuar punonjësish, është e pamundur që të asistojë një person në kushtet e ankuesit të gjithë kohën.

Komisioneri vlerëson se ky qëndrimi i mbajtur nga ana e Bashkisë Fier në lidhje me pranimin e të moshuarve me aftësi të kufizuar në Shtëpinë e të Moshuarve është përjashtues për këtë

¹³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

kategori të moshuarish dhe vjen në kundërshtim me rregullimin ligjor që bëhet në lidhje me mënyrën e ofrimit dhe përfitimit të kësaj kategori të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Të njëjtin qëndrim dhe qasje, ndan edhe SHSSH, i cili thekson se ky institucion nuk i ka refuzuar kërkesat e të moshuarve me aftësi të kufizuar që plotësojnë kriteret ligjore për tu sistemuar në shtëpi të moshuarish dhe se aktualisht në këto qendra ka të moshuar me aftësi të kufizuar të cilët marrin gjithë shërbimet e duhura në përputhje me nevojat e tyre.

Bashkia Fier barazon identitetin e ankuesit si person me aftësi të kufizuar dhe nevojat e tij për të përfituar shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në Shtëpinë e të Moshuarve me gjendjen shëndetësore duke e adresuar këtë si një nevojë që duhet të realizohet në një institucion mjekësor. Komisioneri evidenton se qasja e Bashkisë Fier në lidhje me ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuar është një qasje që në mënyrë të gabuar bazohet në modelin mjekësor dhe jo në modelin bio-psiko-social bazuar në të drejtat e njeriut të aftësisë së kufizuar të vendosur nga KDPAK dhe ligji nr.93/2014.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si autoriteti përgjegjës i ngarkuar nga KDPAK për interpretimin e kësaj Konvente, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, ka interpretuar se: *“Modeli i të drejtave të njeriut të aftësisë së kufizuar pranon se aftësia e kufizuar është një konstrukt social dhe dëmtimet nuk duhet të merren si bazë legjitime për mohimin ose kufizimin e të drejtat e njeriut. Sipas modelit mjekësor të aftësisë së kufizuar, personat me aftësitë e kufizuar nuk njihen si mbajtës të të drejtave, por përkundrazi "reduktohen" tek dëmtimet e tyre. Sipas këtij modeli, trajtimi diskriminues ose diferencial dhe përjashtimi i personave me aftësi të kufizuar shihet si normë dhe legjitimohet nga një qasje e paaftësisë mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar”*.

Mosha në të cilën njerëzit përjetojnë aftësi të kufizuara ndikon në ndjenjën e tyre të identitetit, si dhe në perceptimet shoqërore për ta. Ata që fitojnë dëmtime kur janë më të rriturit, rrallë vetë-identifikohen si persona me aftësi të kufizuara dhe kanë më shumë gjasa të perceptojnë rënien e funksionit të tyre fizik dhe kognitiv si një pjesë "normale" të plakjes. Për njerëzit që kanë patur dëmtime më herët në jetë dhe janë plakur, mosha e vjetër është një identitet dytësor; Prandaj ata mund të kenë pritshmëri shumë të ndryshme për moshën më të madhe. Këto përvoja dhe perceptime të dallueshme individuale reflektohen gjithashtu në mënyrat në të cilat aftësia e kufizuar dhe komunitetet e plakjes trajtojnë kryqëzimin midis plakjes dhe paaftësisë¹⁴.

Moshimi – stereotipizimi, paragjykimi dhe diskriminimi ndaj të moshuarve dhe moshës më të madhe – është një formë e veçantë shtypjeje që prek të moshuarit, duke përfshirë të moshuarit me aftësi të kufizuara. Personat e moshuar shpesh perceptohen si barrë, të varur, joproduktive, të pamerituar ose të pafuqishëm. Ndërsa aftësia e kufizuar, kuptohet gjithnjë e më shumë si një

¹⁴ Raport mbi të drejtat e personave të moshuar me aftësi të kufizuar, hartuar nga Raportuesi Special për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, OKB, Catalina Devandas-Aguilar, publikuar në datë 17.07.2019: <https://www.ohchr.org/en/documents/thematic-reports/report-rights-older-persons-disabilities>.

konstrukt social, pabarazitë për shkak të pleqërisë shihen kryesisht si “natyrore” ose “të pashmangshme” Prandaj, personat e moshuar me aftësi të kufizuara janë të diskriminuar dhe të pafavorizuar jo vetëm për shkak të aftësisë së kufizuar, por edhe për shkak të stereotipeve për të moshuarit. Ndërvprimi midis moshës më të madhe dhe aftësisë së kufizuar rezulton njëkohësisht në një formë të rëndë të diskriminimit dhe shkelje specifike të të drejtave të njeriut ndaj të moshuarve me aftësi të kufizuara¹⁵.

Duke patur parasysh qasjen e Bashkisë Fier, se nëse i moshuari gjatë qëndrimit në Shtëpinë e të Moshuarve humbiste aftësinë e vetëshërbimit, atëherë ishte detyra e institucionit t’i shërbete, edhe pse i kufizohen aftësitë jetësore, por edhe faktin që lloji i shërbimit të kujdesit shoqëror që është objekt shqyrtimi është një shërbim i cili ofrohet për kategorinë e të moshuarve, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm, të cilit i është nënshkruar ankuesi gjatë procesit të përfitimit të shërbimeve rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit të ofruara në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, është pasojë e aftësisë së kufizuar të ankuesit. Trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit në përfitimin e shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror ofruar në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, nuk do të kishte ndodhur nëse ai nuk do ishte i moshuar me aftësi të kufizuar.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë ankuesi A. Z., është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkia Fier, i kalon barra e provës për të provuar se, trajtimi i padrejtë, i disfavorshëm dhe i pavarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Komisioneri konstaton se, justifikimet e paraqitura nga Bashkia Fier se, Shtëpia e të Moshuarve Fier është një institucion social dhe jo një institucion spitalor, apo që ka një numër të kufizuar punonjësisht dhe rrjedhojë e ka të pamundur të asistojë ankuesin si një person me aftësi të kufizuar, nuk mund të shërbejnë si një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi. Përkundrazi si ofruar i shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror për të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, Bashkia Fier, ka detyrimi që të marrë të gjitha masat për ta ofruar këtë shërbim në përputhje me nevojat e tyre.

Komisioneri arrin në përfundimin se, Bashkia Fier ka refuzuar që të përfshijë ankuesin në procesin e përfitimit të shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror që ofrohen për të moshuarit pranë Shtëpisë së të Moshuarve, vetëm për shkak se ankuesi është i moshuar me aftësi të kufizuar dhe se një sjellje e tillë përbën diskriminim të drejtëpërdrejtë për shkak të aftësisë së kufizuar. Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin veprime ose mosveprime të dëmshme të bazuara

¹⁵ Po aty.

në shkaqe të ndaluara, ku nuk ka situatë të ngjashme të krahasueshme. Motivi apo qëllimi i palës diskriminuese nuk është relevant për përcaktimin nëse ka ndodhur diskriminimi.¹⁶

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Përfundimisht ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe zgjidhjen e situatës së tij, duke marrë masa për pranimin e tij në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier.

Sa më sipër, bazuar në situatën e konstatuar dhe kërkimin e ankuesit, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për të rregulluar situatën diskriminuese të konstatuar ndaj ankuesit dhe për të parandaluar sjellje të ngjashme në të ardhmen, është marrja e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Fier për të filluar procesin e përfitimit të shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier, për ankuesin A.Z dhe për të shmangur çdo sjellje diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në aftësinë e kufizuar të personave që duan të përfitojnë nga këto shërbime.

Komisioneri rekomandon Shërbimin Social Shtetëror që bazuar në kompetencat e tij ligjore, të marrin masa, për të udhëzuar dhe asistuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim shmangien e praktikës përjashtuese ndaj personave me aftësi të kufizuar për të përfituar nga shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror për të moshuarit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

¹⁶ Komenti i Përgjithshëm nr. 6 (2018) mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, OKB.

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A.Z për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Fier.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Fier, të marrë masa të menjëhershme:
 - a. Për të trajtuar procesin e përfitimit të shërbimit rezidencial të kujdesit shoqëror pranë Shtëpisë së të Moshuarve Fier për ankuesin A. Z.
 - b. Për të asistuar ankuesin A.Z në çdo hap të procesit të përfitimit të shërbimit.
 - c. Për të shmangur çdo sjellje diskriminuese në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror bazuar në aftësinë e kufizuar të personave që duan të përfitojnë nga këto shërbime.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Fier, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Komisioneri rekomandon Shërbimin Social Shtetëror, që bazuar në kompetencat e tij ligjore, të marrë masa për të udhëzuar dhe asistuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim shmangien e praktikës përjashtuese ndaj personave me aftësi të kufizuar për të përfituar nga shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror, për të moshuarit.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Diskriminim